Republika e Kosovës
Republika Kosova – RepublicofKosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
OpštinaJuzna Mitrovica – Municipalityof Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0055797-1/26 dt. 18.09.2026
Mitrovicë

P R O C E S V E R B A L
Nga mbledhja urgjente e Kuvendit të Komunës
Seanca e 12-të

Koha: 18.09.2026, ora 18:00

Vendi: Salla e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës

Të pranishëm: Anëtarët e Kuvendit: Shkëlqim Ibrahimi, Fisnik Suma, Igballe Islami, Ferdi Kadriu, Majlinda Kurti, Gëzim Stavileci, Artan Berisha, Nazmije Sejdiu, Egzon Sadiku, Valon Brahimi, Egzon Hamza, Liridona Muharremi, Lavdim Zeneli, Kushtrim Zeneli, Erseka Barani, Sazan Ramaxhiku, Bajram Istrefi, Visar Syla, Rinesa Preteni, Xhevdet Osmani, Elfate Ademi Bahtiri, Xhyljeta Imeri, Oltion Ahmeti, Arta Neziri, Gjergj Beka, Jeton Ujkani dhe Flamur Vojvoda

Nënkryetari i Komunës z. Enis Osmani

Përfaqësues të Shoqërisë Civile

Mediat

Mungoi: Armend Begu dhe Rozana Peci,

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi, i cili pasi përshëndeti e të pranishmit theksoi se në Në zbatim të nenit 44 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisje lokale; nenit 3 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ të MAPL-së Nr. 02/2015 Për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës; nenit 50, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenin 12 paragrafi 14 të Rregullores Nr. 12/2013 së Punës Së Kuvendit të Komunës së Mitrovicës,, në cilësinë e Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kam thirrur mbledhjen urgjente (seanca e 12-të), me pikën e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës së Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Jugut lidhur me aktgjykimin e pa drejtë ndaj ish drejtuesve të UÇK-së, Z.Hashim Thaqi, Z. Kadri Veseli, Z. Jakup Krasniqi dhe Z. Rexhep Selimi. Në vazhdim Kryesuesi thekësoi se meqënëse mbledhja është urgjente nuk ka nevojë për miratim të rendit të ditës. Më herët pata një takim me shefat e grupeve parlamentare, ku diskutuam për përmbajtjen e deklaratës dhe u dakorduam rreth saj. Meqenëse jemi dakorduar për përmbajtjen e kësaj deklarate, në emër të Kuvendit të Komunës, për ta lexuar deklaratën, e ftoj Shkëlqim Ibrahimin.

Shkëlqim Ibrahimi: I nderuar Nënkryetar i Komunës, zoti Osmani,

I nderuar Kryesues i Kuvendit, zoti Kamberi,

Të nderuar asambleistë, të nderuar drejtorë, të nderuara media, të nderuar të pranishëm dhe ju, të dashur qytetarë të Mitrovicës,

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut, shpreh mospajtimin e tij të thellë me aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, të datës 16 shtator 2026, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Kuvendi konsideron se, për një dënim penal të kësaj peshe, përgjegjësia personale e secilit të akuzuar duhet të provohet me prova të qarta, konkrete, bindëse dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Kuvendi shpreh shqetësimin e tij se përgjegjësia penale individuale nuk duhet të ndërtohet mbi supozime, përgjithësime, dëshmi të tërthorta apo mbi lidhje të nxjerra nga pozita politike dhe ushtarake që individët kanë mbajtur gjatë luftës.

Kuvendi vlerëson se vetë Trupi Gjykues ka shpallur të akuzuarit të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit, pasi është konstatuar se Prokuroria nuk kishte arritur të provonte përtej dyshimit të arsyeshëm ekzistencën e një sulmi të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile. Po ashtu, pafajësi janë dhënë lidhur me një numër incidentesh të tjera të pretenduara.

Për Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, kjo dëshmon rëndësinë themelore që standardi "përtej dyshimit të arsyeshëm" duhet të zbatohet me të njëjtin rigorozitet për çdo akuzë, çdo formë përgjegjësie dhe ndaj secilit të akuzuar veçmas.

Kuvendi konsideron se, kur pas një procesi shumëvjeçar mbeten paqartësi serioze mbi lidhjen konkrete të individit me veprën penale, këto paqartësi nuk mund të plotësohen me perceptime, dëshmi indirekte apo me përgjegjësi të nxjerrë vetëm nga hierarkia organizative.

Për këtë arsye, Kuvendi shpreh qëndrimin se, nëse përgjegjësia individuale e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm me prova bindëse dhe të drejtpërdrejta për elementet përkatëse të veprave penale, rezultati juridik duhet të ishte shpallja e tyre të pafajshëm.

Në fund, duhet të theksojmë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është fundi i procesit. Procedura e ankimimit është pjesë e drejtësisë dhe ne duhet të shprehim pritjen që aty të shqyrtohen me kujdes të gjitha pretendimet, provat dhe çështjet që lidhen me përgjegjësinë individuale.

Duke pasur parasysh se vendimi u shpall me formulimin "Në emër të popullit të Kosovës", Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut përcjell qartë mesazhin e qytetarëve të saj: **"JO NË EMRIN TIM!"**

Kjo është shprehje e mospajtimit me këtë dënim dhe e të drejtës për të kërkuar drejtësi për udhëheqësit e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Kryesuesi i Kuvendit Safet Kamberi: Po ashtu u dakorduam që kësaj deklarate t'i shtohen edhe tre paragrafë tjerë:

1. Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut rithekson se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte vazhdimësi e luftës për liri dhe çlirim, e lindur nga rrethanat e rënda të represionit, dhunës, vrasjeve dhe dëbimit të popullsisë shqiptare të Kosovës.
2. Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut shpreh solidaritet me familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, si dhe me të gjithë ata që këtë proces e kanë përjetuar me dhimbje dhe shqetësim.
3. Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut u bën thirrje qytetarëve të Mitrovicës dhe të gjithë Kosovës që, përkundër dhimbjes dhe emocioneve të forta, të ruajnë qetësinë,

dinjitetin dhe unitetin, duke shprehur qëndrimet e tyre në mënyrë paqësore dhe institucionale.

Kjo ka qenë një pajtueshmëri mes të gjithë shefave të grupeve parlamentare.

Në vazhdim Kryesuesi i Kuvendit vuri në votim këtë Deklaratë:

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut, në mbledhjen e mbajtur më datë 18.09.2026, nxjerrë këtë:

DEKLARATË

Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut, duke respektuar pavarësinë e gjyqësorit, shpreh mospajtimin e tij të thellë me aktgjykimin e shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës, të datës 16 shtator 2026, ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Kuvendi i Komunës rithekson se lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ishte vazhdimësi e luftës për liri dhe çlirim, e lindur nga rrethanat e rënda të represionit, dhunës, vrasjeve dhe dëbimit të popullsisë shqiptare të Kosovës.

Kuvendi konsideron se, për një dënim penal të kësaj peshe, përgjegjësia personale e secilit të akuzuar duhet të provohet me prova të qarta, konkrete, bindëse dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

Kuvendi shpreh shqetësimin e tij se përgjegjësia penale individuale nuk duhet të ndërtohet mbi supozime, përgjithësime, dëshmi të tërthorta apo mbi lidhje të nxjerra nga pozita politike dhe ushtarake që individët kanë mbajtur gjatë luftës.

Kuvendi vlerëson se vetë Trupi Gjykues ka shpallur të akuzuarit të pafajshëm për akuzat për krime kundër njerëzimit, pasi është konstatuar se Prokuroria nuk kishte arritur të provonte përtej dyshimit të arsyeshëm ekzistencën e një sulmi të përhapur ose sistematik kundër popullatës civile. Po ashtu, pafajësi janë dhënë lidhur me një numër incidentesh të tjera të pretenduara.

Për Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, kjo dëshmon rëndësinë themelore që standardi "përtej dyshimit të arsyeshëm" duhet të zbatohet me të njëjtin rigorozitet për çdo akuzë, çdo formë përgjegjësie dhe ndaj secilit të akuzuar veçmas.

Kuvendi konsideron se, kur pas një procesi shumëvjeçar mbeten paqartësi serioze mbi lidhjen konkrete të individit me veprën penale, këto paqartësi nuk mund të plotësohen me perceptime, dëshmi indirekte apo me përgjegjësi të nxjerrë vetëm nga hierarkia organizative.

Për këtë arsye, Kuvendi shpreh qëndrimin se, nëse përgjegjësia individuale e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit nuk është provuar përtej dyshimit të arsyeshëm me prova bindëse dhe të drejtpërdrejta për elementet përkatëse të veprave penale, rezultati juridik duhet të ishte shpallja e tyre të pafajshëm.

Kuvendi i Komunës shpreh solidaritet me familjet e Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, si dhe me të gjithë ata që këtë proces e kanë përjetuar me dhimbje dhe shqetësim.

U bën thirrje qytetarëve të Mitrovicës dhe të gjithë Kosovës që, përkundër dhimbjes dhe emocioneve të forta, të ruajnë qetësinë, dinjitetin dhe unitetin, duke shprehur qëndrimet e tyre në mënyrë paqësore dhe institucionale.

Në fund, duhet të theksojmë se aktgjykimi i shkallës së parë nuk është fundi i procesit. Procedura e ankimimit është pjesë e drejtësisë dhe ne duhet të shprehim pritjen që aty të shqyrtohen me kujdes të gjitha pretendimet, provat dhe çështjet që lidhen me përgjegjësinë individuale.

Duke pasur parasysh se vendimi u shpall me formulimin "Në emër të popullit të Kosovës", Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Jugut përcjell qartë mesazhin e qytetarëve të saj:

"JO NË EMRIN TIM!"

Kjo është shprehje e mospajtimit me këtë dënim dhe e të drejtës për të kërkuar drejtësi për udhëheqësit e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi.

Rezultati i votzimit: 28 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.
Kryesuesi e konstatoi të miratuar unanimisht Deklaratën.

Kryesuesi i Kuvendit i mbylli punimet në ora 18:22 min.

Mitrovicë
18.09.2026

Procesmbajtës:

Merita PRETENI

Kryesuesi i Kuvendit

Safet KAMBERI